



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.146/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Gjeriq, kryetare e kolegjit, Beshir Islami dhe Rustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të kreditorit: Banka Ekonomike Sh.A me seli në Prishtinë, kundër debitorëve përmbares: 1. S. A. me vendbanim në Mitrovicë, rruga D.P.T "A..." me seli në Mitrovicë, 3. A. A. me vendbanim në Mitrovicë, rruga ... dhe 4. L. Q. me vendbanim në Mitrovicë, rruga... , me objekt kontesti-përmbarem, duke vendosur sipas konfliktit të kompetencës lëndore ndërmjet: Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, në seancën e mbajtur më 04.02.2024, nxjerr këtë

A K T V E N D I M

1. Për të gjykuar në çështjen juridike të kreditorit: Banka Ekonomike Sh.A me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. S. A. me seli në Mitrovicë, rruga..., 2. D.P.T "..." me seli në Mitrovicë, 3. A. A. me vendbanim në Mitrovicë, rruga ... dhe 4. L. Q. me vendbanim në Mitrovicë, rruga ..., me objekt kontesti – përmbarem, **KOMPETENTE NË PIKËPAMJE LËNDORE** është Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm.
2. Shkresat e lëndës duhet transferuar asaj gjykate në procedime të mëtejshme.

A r s y e t i m

Në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, më 06.05.2008, kreditori ka parashtruar propozim për përmbarem, kjo gjykatë duke vendosur sipas të njëjtit me datë 20.05.2013 ka lejuar përmbaremin në shumën prej 2.092,80 euro në emër të përmbaremit, në raport me debitorë më datë 20.05.2013 me numrin: I.nr.124/08. Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm me 11.11.2022 nxjerr aktvendimin I.nr. 124/08 me të cilin shpallet

jokompetente për vepruar sipas çështjes lëndore, duke theksuar se kompetente është Gjykata Komerciale në Prishtinë.

Dhoma e Shkallës së Parë e Gjykatës Komerciale e Kosovës nuk e ka pranuar juridiksionin lëndor dhe me datë 29.02.2024. ka nxjerrë vendimin KPPP.nr.36/23 dhe lëndën e ka dorëzuar në Gjykatën Supreme të Kosovës për zgjidhje të konfliktit të kompetencës.

Duke zgjidhur konfliktin e krijuar të kompetencës lëndore, bazuar në dispozitën e nenit 25, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), Gjykata Supreme ka gjetur se për të vepruar sipas kësaj çështje lëndore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm.

Në situatën konkrete me rastin e vendosjes se cila gjykatë është kompetente në aspektin lëndor që të veproj dhe vendos në këtë çështje lëndore, Gjykata Supreme si fakt vendimtar e ka marrë se çështja konkrete juridike gjendet në procedurën e përmbarimit.

Dispozita e nenit 1 të Ligjit për procedurën përmbarimore parasheh që, citohet: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe”*.

Dispozitat e nenit 12, paragrafi 1 dhe nenit 20 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 06/L-054) parashikojnë kompetencën e Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.

Dispozita e nenit 13, paragrafi 1, pika: 1.1 dhe 1.2 e Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës (Ligji nr. 08/L-015) parasheh që Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, mes tjerash dhe në rastet si në vijim: *” 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në çështjen konkrete juridike që ka të bëj me përmbarrimin, është Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se me aktvendim është lejuar përmbarrimi dhe se nuk është përdorur asnjë mjet juridik kundër aktvendimit të cekur. Kreditori përmbarrues nuk ka kërkuar që lënda t'i transferohet përmbarruesit privat siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 397 të Ligjit për procedurën përmbarrimore (Ligji nr. 04/L-139), kështu që Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, bazuar në rrethanat e lartpërmendura, nuk ka mundur ta shpallet inkompetente në aspektin lëndor në rastin konkret, por duhej të vazhdonte procedurën në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për procedurën përmbarrimore. Në rastet kur bëhet fjalë për procedurën e përmbarrimit në bazë të propozimit të kreditorit, në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Dhoma e Shkallës së Parë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, sepse e njëjta vendos vetëm për mjetet juridike që ushtrohen kundër përmbarrimeve të lejuara, kurse në rastin kut palët nuk ushtrohet asnjë mjet juridik (prapësim apo ankesë), kompetente në pikëpamje lëndore është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore.

Marrë parasysh këtë që u parashtrua, Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në dispozitat e nenit 25, par. 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

CN.Nr.146/2024, data 02.04.2024.

**Kryetare e kolegjit,
gjqtare
Milena Gjeriq**